



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A.nr.694/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – thyerja e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 21.10.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Hudhet e palejuar ankesa** A.nr.694/2021, e datës 18.10.2021, parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, e paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike – Thyerja e Heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17.10.2021.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 20.10.2021, PZAP-i, nëpërmjet postës ka pranuar ankesën Anr.694/2021 e dorëzuar në postë më datë 18.10.2021, të parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Viti me të cilin thekson se Lëvizja Vetëvendosje(LVV), ka vendosur posterin në një madhësi 2x2 në një objekt në afërsi të Qendrës Votuese (QV),2601x, në qytetin e Vitisë. Parashtruesi i ankesës thekson se vendosja e këtij posteri ka qenë në afërsi më të vogël se 50 m. nga QV.

Ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi të printuara si provë materiale.

Paneli pasi qe shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se: **Ankesa është e palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)-dega në Viti, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur me datën 17.10.2021 kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.631/2021 të datës 18.10.2021.

Nga kjo gjendje rezulton se ankesa e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.631/2021 të datës 18.10.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.694/2021 më datën 21.10.2021

**Kryesues i Panelit**  
**Faton Ademi**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e pa lejuar ankesa.